



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E METROLOGJISË LIGJORE

Nr. 338/ prot.

Tiranë, më 06.02.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Të nderuar,

Në përgjigje të shkresës Tuaj dërguar me e-mail në DPM në datën 12.02.2024 dhe protokolluar nga ne me Nr.338 Prot. datë 12.02.2024, në lidhje me kërkesën për informacion për konformitetin ose jo të etiketës me të dhënat e peshoreve të cilat kompania ka shfaqur interes për të hedhur në treg instrumente të tillë, Ju informojmë si më poshtë vijon :

Vendosja në treg e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara duhet të kryhet në zbatim të ligjit Nr.126/2020, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", konkretisht nenit 18 "Vendosja në treg dhe/ose vënia në përdorim e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara", në të cilin theksohet se: "Instrumentet matëse, që janë objekt i markimit CE, vendosen në treg dhe/ose vihen në përdorim nëse kanë markimin CE, Markimin Metrologjik Suplementar M dhe dy shifrat e fundit të vitit të prodhimit të rrethuara nga një drejtkëndësh, lartësia e të cilit është e njëjtë me lartësinë e markimit CE; numrin unik të trupës notifikuese që ka marrë pjesë në fazën e kontrollit të prodhimit, i cili vendoset nga vetë trupa ose, sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, nëpërmjet së cilës prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi garanton se instrumenti matës është në përputhje me kërkesat metrologjike të përshkruara" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 631, dt 25.09.2019 Për miratimin e rregullit teknik "Për instrumentet e peshimit joautomatik" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara".

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Petrit Rama

